



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.50/2016

Prishtinë, më 15.3.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës i ftuar: Petrit Gashi, kryesues i Bordit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP.

Pjesëmarrës të tjerë: Haxhi Arifi, Adem Selishta dhe Avni Jashari – AKP, Fjolla Uka – KDI, Visar Berisha – INDEP, Lekë Batalli – GLPS, Kenan Gashi dhe Faton Haxhisalihu – AVONET, Florina Ejupi – BIRN, Visar Preberza – Koha Ditore, Dona Llukaj dhe Dugagjin Maliqi - RTV Dukagjini, Albulena Mavraj - Epoka e Re dhe Evlina Kabashi, praktikante e Komisionit.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 8.3.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP, për vitin 2014;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shofer;
5. Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për anëtarë të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, të propozuar nga Qeveria;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendit i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8.3.2016;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 8.3.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP për vitin 2014;

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha që po e trajtojmë më shumë vonesë, për arsye që tashmë dihen, në mungesë të Bordit të AKP-së, dhe neve si Komision, nuk kemi pas të drejtë ta shqyrtojmë raportin e punës për vitin 2014. Por tani pasi që ka Bord dhe ky Bord është deklaruar se e ka studiuar këtë raport, ne për shkak të procedurave duhet ta trajtojmë. Efekti i trajtimit është të nxjerrim mësim për çështjet aktuale, sepse AKP-ja ka ende të papërfunduar procesin e privatizimit dhe likuidimit dhe për këto çështje duhet të kemi informata së deri ku ka arritur ky proces dhe për këtë çështje kemi përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, theksoi Mustafa.

Petrit Gashi, kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit– (AKP), tha se si bord i ri i AKP-së, detyrën e kemi filluar në dhjetor të vitit 2015 dhe Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2014, është formuluar shumë kohë më përpara dhe neve kur kemi filluar vetëm e kemi aprovuar si Bord. Gashi kërkoi që z. Avni Jashari, u.d i drejtorit menaxhues të AKP-së, të paraqesë ekspozenë e Raportit pasi që është pjesë aktive e AKP-së dhe është në ngjarje për gjitha detajet.

Avni Jashari, ud i drejtorit menaxhues të AKP-së, paraqiti ekspozenë e Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP për vitin 2014. Për AKP-ën sfidë ka qenë mungesa e bordit. Kjo ka ndikuar negativisht në shumë aktivitete të parapara të AKP-së që mos realizohen në tërësi objektivat e punës për vitin 2014. Raportit vjetor për vitin 2014, i plotëson të gjitha kushtet për publikim; Lista e raporteve financiare vjetore është e bashkangjitur në raportin 2014. Në mbledhje u diskutua rreth aseteve, trajtimit të aseteve të uzurpuara dhe rreth sfidave të së ardhmes. Sa i përket sfidave kryesore të AKP-së, janë të ndërlidhura me mungesën e tre anëtarëve të Bordit të Drejtorëve. Ky Bord ka funksionuar vetëm me 5 (pesë) anëtarë, ndër të cilët 2 (dy) prej tyre ishin ndërkombëtarë. Pas përfundimit të mandatit të anëtarëve ndërkombëtarë, Bordi ka funksionuar vetëm me 3 (tre) anëtarët e mbetur. Kjo mungesë e anëtarëve të Bordit ka ndikuar që disa detyra, si pagesa e fondeve dhe pagesat tepriçë të mos aprovohen. Detyrat e tjera përpos këtyre të drejtësisë, janë përfunduar me sukses. Gjatë vitit

2014, kanë filluar procedurat e likuidimit edhe për 123 ndërmarrje shoqërore, përderisa numri total i këtyre ndërmarrjeve, për të cilat ka filluar procesi i likuidimit është 460. Gjatë nëntorit 2014, është bërë trajtimi i aseteve të uzurpuara. Në këtë formë është rritur besimi ndërmjet palëve. Gjithashtu, ka pasur edhe bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ku janë trajtuar disa raste të aseteve të uzurpuara, 8 (tetë) nga të cilat janë liruar. Duke marrë në konsideratë pengesat e njëpasnjëshme që kanë paraqitur uzurpatorët para dhe gjatë procesit të shitjes, më 21 nëntor 2014, menaxhmenti ka marrë vendim që tash e tutje të gjitha asetet që do të publikohen për shitje, paraprakisht të lirohen nga uzurpatorët me ndihmën e Policisë së Kosovës dhe se asnjë kontratë nuk do të përfundohet apo dorëzohet të blerësi pa u liruar aseti nga uzurpatorët. Inkasimi i qirasë është rritur për 56%. Gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka publikuar 13 lista të punëtorëve. Pritet vendimi i Dhomës së Posaçme për shpërndarjen e 20 përqindëshit. Për vitin 2014, AKP-ja ka pasur tetëmbëdhjetë objektiva. Ndër to ka qenë shitja e 1500 aseteve, por AKP-ja ka arritur të shes vetëm 40% të tyre. Në gjykatë janë bërë gjithsej 29000 ankesa, kështu që, duhet të përgatitet një njësi speciale, e cila do të punojë rreth shqyrtimit të këtyre ankesave në gjykatë. Në fund, z. Jashari theksoi, se sa i përket listave të pagesave të 20% të ish- punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore gjatë vitit 2014, 312 lista të punëtorëve janë publikuar ndërsa 217 kanë qenë në pritje.

Muhamet Mustafa, kryetar, theksoi se tash e tutje duhet të shohim se si po shkon i tërë procesi i privatizimit të shitja me likuidim sepse nuk ka pas dinamike të përshpejtuar. Çështja e uzurpimeve po shihet se ka filluar të lëvizë në drejtim të zgjidhjes, çështja lirimit të Fondit të Privatizimit do të ketë një imobilizim, duke shfrytëzuar këtë fond në të mirë të zhvillimit ekonomik.

Besim Beqaj, tha se shqyrtimi i Raportit vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2014, nuk ka ndonjë vlerë tani pas dy viteve sepse parimisht këto janë çështje të kaluara, por për çështje të procedurave mund ti diskutojmë. Ai theksoi se në raport janë disa të dhëna të pasqyruara, por për çështjen e monitorimit të rregullt të ndërmarrjeve të privatizuara, nuk ka të dhëna të qarta, prandaj raporti është goxha i mangët në këtë drejtim. Beqaj theksoi se ndërmarrjet e privatizuara, thuhet në raporte se i kanë plotësuar kushtet, nëse themi që ato prodhojnë në bazë individuale atëherë sipas parimit nuk i kanë plotësuar kushtet, duhet të qartësohet raporti më të dhëna të sakta se sa është numri i ndërmarrjeve që nuk i kanë plotësuar kushtet gjatë monitorimit.

Blerim Grainca, tha se pajtohet me kolegët së raporti po shqyrtohet më vonesë, por janë disa të dhëna që duhet t'iu referohemi. Ai pyeti për trajtimin e pronave të uzurpuara se ky numër i aseteve të uzurpuara, a ka pas mundësi të lirohen më herët dhe ku qëndron problemi? Për nënshkrimin e kontratave me kompanitë që iu ofrojnë shërbime AKP-së, lidhur me çështjen e likuidimit, a i kanë plotësuar kushtet e parapara më kontratë? Grainca ngriti nevojën e mbylljes së procesit të privatizimit, ku duhet të ketë një limit kohor se kur do të mbyllet ky proces. Për "Spin-off-in Special" ka pas kritika të shumta se nuk janë zbatuar kriteret njëjtë për të gjitha ndërmarrjet dhe thuhet ka pas dallime në kriteret të përmbushjes. Për Fabrikën e Tubave në Ferizaj, lidhur me buxhetin e pagesave, duhet të trajtohet në Qeveri dhe Kuvend se si të gjendet

mënyra e zgjidhjes së këtij problemi. Ai theksoi së janë probleme të mëdha që e presin AKP-në, siç është çështja e “Trepçës” dhe raporti me Gjykatën e Dhomës së Posaçme për kontestet e lëndëve e që kanë të bëjnë me AKP-në, prandaj çështja e “Trepçës” do të duhet të jetë një çështje parësore në punën e Bordit të AKP-së.

Raif Qela, tha se duke e shqyrtuar tani Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2014, nuk ka ndonjë vlerë, pasi duhet respektuar vetëm procedurat e përcaktuara me Ligjin e AKP-së. Qela foli për imazhin e keq që ka pas kjo Agjenci që nga themelimi i saj, por tani disa hapa që i ka ndërmarrë Bordi i ri i AKP-së, janë hapa të qëlluar dhe për t’u përshëndetur, sidomos publikimi i listave të uzurpatorëve të ndërmarrjeve shoqërore, që janë nën menaxhimin e AKP-së, përgaditja e termave të referencës për TREPÇËN si dhe organizimi i takimit me palë të interesit lidhur me këtë çështje.

Duda Balje, parashtroi dy pyetje; pyeti për regjionin e Prizrenit, që kanë mbetur pronat shoqërore , sidomos toka bujqësore të paprivatizuara ende, kur pritet të fillojë privatizimi i këtyre pronave, ngase siç tha Balje, ka pas interesim nga banoret e këtyre fshatareve të Prizrenit për t’i privatizuar këto prona? Balje pyeti po ashtu se a ka AKP-ja staf të mjaftueshëm në resurset njerëzore për privatizim?

Petrir Gashi, kryesues i Bordit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), tha Bordi i AKP-së do të hartojë një plan të punës me aktivitete të veprimit se cilat do të jenë prioritetet e AKP-së për vitin 2016. Pastaj, ai iu përgjigj pyetjeve të parashtruara, për hartimin listave të shitjes dhe likuidimin e ndërmarrjeve. Gashi tha që ende nuk kanë filluar të merren në mënyrë intensive me këtë proces, pasi që kanë pasur probleme të tjera më primare brenda AKP-së. Sa i përket uzurpatorëve të pronave, kemi filluar që të jemi sa më transparent me publikun. Po ashtu, jemi duke bërë edhe shpalljen e listave të privatizuesve edhe për pronat që janë dhënë më qira nga ana AKP-së. Ai tha se pas publikimit të listave të uzurpatorëve të pronave shoqërore, kemi pas takime me Policinë dhe Prokurorinë e Shtetit për këtë çështje, kemi pas kërkesë edhe nga Qeveria dhe Kuvendi që këto probleme të zgjidhen sa më shpejtë. Për imobilizimin e fondit të privatizimit nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore të privatizimit, Gashi tha që Ministra e Financave e ka iniciuar plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për AKP-në, dhe me ndryshimin e Ligjit, këto fonde mund të aktivizohen edhe me letrat me vlerë. Për trajtimin e uzurpimeve, tani ky proces vetëm ka filluar të trajtohet. Përcaktimi i limitit kohor për mbyllje të privatizimit, tha që do të jetë edhe në mandatin e Bordit të AKP-së. Ajo çka varet prej neve dhe që është në përgjegjësi të Bordit të AKP-së, sa më shpejt që të jetë mundur të mbyllet ky proces i privatizimit. Për Fabrikën e Tubave në Ferizaj, tha që jemi takuar dy herë me përfaqësuesit fabrikës, dhe kjo është një çështje me të cilën do të merremi , por që nuk është aq e lehtë të zgjidhet. Për kompaninë që është angazhuar për likuidim të ndërmarrjeve, tha që na duhet edhe pak kohë për të shikuar kontratën se cilat shërbime i ka përfunduar. Për “Trepçën”, tha që e kemi iniciuar dhe diskutuar me të gjitha institucionet përkatëse dhe jemi në fund të referencave për paraqitjen e projektit të fizibilitetit. Për Dhomën e Posaçme, tha që nuk varet shumë prej bordit të AKP-së, por duhet të gjendet mënyra se si ti trajtojmë këto lëndë dhe kërkesa që kanë konteste gjyqësore.

Avni Jashari, u.d. i drejtorit menaxhues të AKP-së, iu përgjigj pyetjeve të parashtruara, për burimet njerëzore të AKP-së dhe tha që nuk mungojnë dhe se AKP-ja ka staf për këtë sektor.

Për monitorimin të ndërmarrjeve të privatizuara, tha që ka pas monitorime të vazhdueshme, por që mungesa e Bordit të AKP-së ka bërë që mos të jenë aq efikase këto monitorime. Për privatizimin e tokave bujqësore, tha që ka ende toka të paprivatizuara, por që për këtë çështje është duke u përgatitur numri se sa prona kanë mbetur të paprivatizuara. Ka interesim por që në bazë të Ligjit dhe Rregullores së AKP-së, nuk lejohet shitja drejtpërdrejt, por procesi i privatizimit siç e dini është i rregulluar më hapjen ofertave për aplikim dhe për hapjen e valës së re të privatizimit, do merret vendim shumë shpejt nga Bordit i AKP-së.

Besim Beqaj, potenco i se në Raportin e punës së vitit 2014, është cekur se keni angazhuar një kompani të auditimit, këtu në këtë raport në faqen 36-37, ka hapësirë për t'i qartësuar të dhënat faktike që janë për disa ndërmarrje të privatizuara më privatizimin më kusht që të ruhet veprimtaria e njëjte, siç është ndërmarrja "Hotel Onix Banja e Pejës", "Emin Duraku", "Fabrika e Bativerive" etj, Lidhur më gjitha këto, gjetjet të auditorit që janë faktike, e jo çka keni parë në terren vizualisht, është dashur ti paraqitni edhe ju si AKP, sepse nuk i keni paraqitur në aktivitetet tuaja këto të dhëna, andaj është përgjegjësi e AKP-së për marrjen e vendimeve për të pasqyruar drejtë procesin e auditimit të privatizimit më të dhëna faktike.

Avni Jashari, u.d. i drejtorit menaxhues të AKP-së, tha se këto ndërmarrje janë privatizuar që nga viti 2010-2011, me privatizimin me kushte, është e saktë se auditori nuk ka gjetur sasinë prodhimit të paraparë edhe s'ka mundur të konstatojë këto të dhëna. Problemi qëndron te kontrolli i shitjes që nuk është i definuar qartë se kush duhet të kontrollojë dhe mbikëqyrë këto investime se po bëhen qoftë edhe në prodhime, andaj për të ardhmen do të përcaktojmë më saktë nivelin dhe kontrollin e mbikëqyrjes së këtyre ndërmarrjeve të privatizuara më kushte të veçanta të privatizimit.

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se e patëm një diskutim mjaft të dobishëm dhe në fund mund t'i nxjerrim këto konkluzione me këto rekomandime: sa më shpejt të hartohet një plan kohor i përmbylljes së procesit të privatizimit; në raportet vijuese raportimi dhe të dhënat të jenë sa më të qarta, lidhur më ndërmarrjet që janë nën monitorim dhe administrim dhe; Fondi i Privatizimit të mos mbetet i bllokuar dhe për këtë fond të hartohet një plan strategjik për imobilizimin e tij, dhe ky fond të përdoret për investimet në zhvillim ekonomik.

Pas debatit Komisioni, njëzëri, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. *Kuvendi i Republikës së Kosovës të shqyrtojë Raportin Vjetor të punës për vitin 2014, të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP dhe të miratojë me rekomandimet si vijon:*
 - *Bordi dhe menaxhmenti i AKP-së, të përpilojë një plan të kornizës kohore të përmbylljes së procesit të privatizimit dhe likuidimit, përkatësisht të përshpejtimin të përfundimit të tij në një afat të arsyeshëm;*
 - *Në raportet vijuese të jepet një pasqyrë detale e monitorimit të ndërmarrjeve në mbikëqyrje dhe administrim, lidhur më përmbushjen e obligimeve kontraktuese;*

- *Institucionet kompetente – Qeveria, Kuvendi dhe AKP-ja – të angazhohen për gjetjen e një zgjidhje për evitimin e imobilizimit të fondeve të privatizimit dhe përdorimin e tyre në funksion të zhvillimit ekonomik.*

2. *Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, kryetari i Komisioni, Muhamet Mustafa.*

4.Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shofer;

Muhamet Mustafa, kryetar, njoftoi se Komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin Nr. 05/L-064 për Patentë Shofer dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional dhe përveç Komisionit për Legjislacion që ka dhënë disa propozime, të tjerat komisione nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje apo propozim. Pasi që z. Raif Qela e ka kryesuar grupin e punës, ai e mori fjalën.

Raif Qela, tha se i ka shqyrtuar rekomandimet e Komisionit për Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, sepse vetëm ky komision ka paraqitur vërejtje dhe ka dërguar rekomandime. Sa i përket rekomandimit të *Amendamenti 4*, propozoj që të mos përkrahet sepse çështja ka të bëjë me “Patentë shoferin ndërkombëtar” dhe si e tillë nuk është kuptuar nga ai komision dhe ne, këtë formulim e kemi marrë nga ministria dhe duhet të jetë kështu siç është. Ndërsa, te rekomandimi tjetër te *Amendamenti 17*, që kanë thënë “duhet të hiqen fjalët “të në të holla”, nuk qëndron sepse dënimi më gjorbë mund të jetë edhe në detyrim e jo vetëm në të holla dhe në këtë e kemi precizuar më mirë dhe më saktë, po ashtu në fjalorin e gjuhës shqipe thuhet saktë “dënim me gjorbë në të holla”. Ndërkaq, lidhur me propozimin te *Amendamentet 20,22,25,28,29,30,26,45,49,50,92,94 dhe 95*, së pari ju njoftoj se këto 13 amendamente të kontestuara i përkasin atyre si njëjtë dhe kanë të bëjnë me propozimin tonë apo përcaktimin për kryesin e veprave penale. Ne jemi përcaktuar te modeli sloven, ku ata i kanë të selektuara në këtë formë, siç kemi bërë ne me amendament por, sipas Komisionit për Legjislacion, kjo formë nuk është standard i mirë dhe nuk mund të ketë me Ligj të veçantë ndarje të veprave penale, dhe ata i kanë bërë dy propozime si vijon: “*Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale*” ose “*Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale më shumë se gjashtë muaj burgim*”. Pasi që Komisioni për Legjislacion është kompetentë në këtë fushë, propozoj që të pranohet propozimi i dytë i Komisionit për Legjislacion. Në fund propozoj që edhe te Neni 46 i P/Ligjit të zvogëlohet numri i “*orëve praktike për kategorinë B, nga 30 në 20 orë*” dhe kjo të harmonizohet sikurse me Nenin 44, sa i përket orëve nga pjesa teorike e aftësimit të kandidatit për kategorinë B.

Komisioni i përkrahu propozimet e z.Raif Qela.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit Nr. 05/L-064 për Patentë Shofer;

2. Raporti me Rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

5. Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për anëtarë të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, të propozuar nga Qeveria;

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se Qeveria në bazë të Ligjit për Miniera dhe Minerale, e ka propozuar listën e kandidatëve për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, dhe tani kjo listë e kandidatëve është sjellë në Kuvend. Ne si Komision FunkSIONAL duhet të shqyrtojmë listën e kandidatëve të propozuar nga Qeveria, ku janë propozuar dy kandidatë, ndërsa Kuvendi duhet të zgjedhë njërin prej tyre. Ai i prezantoi kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë kandidatët për t'u emëruar anëtarë të Bordit të KPMM-së, që rregullohen me paragrafin 6 dhe 7, të nenit 59, të Ligjit për Miniera dhe Minerale, ku sipas këtij ligji kandidatët i plotësojnë kushtet formale.

Besim Beqaj, tha se sa i përket kushteve ligjore se a i plotësojnë a jo kandidatët e propozuar, e kam thënë edhe me parë, se është përgjegjësi e Zyrës Ligjore të Qeverisë dhe e Zyrës Ligjore të Kuvendit, e jo e jona si Komision.

Pas debatit, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të emërohet 1 (një) nga 2 (dy) kandidatët e propozuar nga Qeveria, për anëtar të Bordit për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM, më mandat 5 (pesë) vjeçar, si vijon:

- 1.1. Ismet Hashani*
- 1.2. Avdi Konjuhi*

2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

6. Të ndryshme.

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit rreth një vizite zyrtare në Hagë, më 3-4 prill 2016, ku temë do të jetë energjia, ku ai është ftuar ai si kryetar dhe se me këtë rast duhet të caktohen edhe dy deputet nga Komisioni.

Komisioni vendosi që në këtë vizitë pjesëmarrës të jenë: Muhamet Mustafa, kryetar, Raif Qela dhe Blerim Grainca, anëtarë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa